



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova



Komuna Podujevë / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KOMUNA E PODUJEVËS
DREJTORA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT
Datë 11.07.2024

Bazuar në nenin 62 pika 3, të ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040. Rregulloren MF-Nr.04/2017, mbi kriteret standarde dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neni 61 paragrafi 1 dhe 2 të statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01-0050862/18 dhe Vendimit të Kryetarit të Komunës për shpalljen e thirrjes publike për mbështetje financiare publike për projektet, programeve të organizatave joqeveritare në Komunën e Podujevës nr. Protokollit 02-401/01-0044836/24 datës 10.07.2024.

THIRRJE PUBLIKE

Për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekt propozimeve të OJQ-ve, për organizimin e aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive në Komunën e Podujevës.

1. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Podujevës, u bënë thirrje të gjitha OJQ-ve të regjistruara në Republikën e Kosovës, të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në zhvillimin dhe masivizimin e organizimeve Kulturore, Rinore dhe Sportive, promovimin përmes pasurimit, diversifikimit dhe rritjes së cilësisë së jetës kulturore, rinore dhe sportive, gjithnjë duke u bazuar në politikat programore të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, në Komunën e Podujevës.

2. OJQ-të dhe klubet sportive në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projekt/propozimet për organizimin e aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive.

3. OJQ - të, mund të aplikojnë me vetëm një projekt që kontribuon në organizimet në Kulturë, Rini dhe Sport përmes aktiviteteve si më poshtë:

Ngjarje/Aktivitete kulturore, artistike, tradicionale:

- *Kinematografi (projekte filmike, festivale etj);*
- *Artin pamor,*
- *Balet dhe forma të tjera të vallëzimit;*
- *Manifestime – shënimi i datave tradicionale dhe Ditët e Diasporës, Muaji i Rinisë, 28 nëntori, etj...*

- *Art në hapësira publike;*
- *Promovimi i Turizmit kulturor;*
- *Festivale në fusha të ndryshme të arteve dhe kulturës;*
- *Panairi i librit;*
- *Panair në artin tradicional, punime artizanale, etj;*
- *Promovimi i trashëgimisë kulturore;*
- *Projekte që targetojnë grupet e marginalizuara;*
- *Aktivitete të tjera në kulturë dhe arte.*

Ngjarje/Aktivitete rinore: Mbështetja për përfshirjen sociale, organizimi i kampingjeve, sesioneve edukative;

- *Projekte në fushën e rinisë (ndërmarrësi, teknologji dhe inovacion, sociale etj);*
- *Organizimi i ngjarjeve/aktiviteteve rinore gjatë ditëve të diasporës dhe ditëve të tjera të rëndësishme të përmendura më lart;*
- *Integrimi i grupeve rinore;*
- *Aktivitete kunder Bullizmit dhe dukurive të tjera negative në shkolla dhe përgjithësisht në jetën publike.*
- *Aktivitete të tjera që targetojnë të rinjtë, të paspecifikuara në këtë thirrje.*

Ngjarje/Aktivitete edukuese si:

- *Seminare;*
- *Trajnime;*
- *Kurse për aftësimin e të rinjve;*
- *Programe dhe gara shkollore;*

Ngjarje/Aktivitete sportive:

- **Masivizim i sportit**
 - *Promovim i talentëve të reja;*
 - *Masovizimi i sportit për të rinj;*
 - *Avancim i aktiviteteve në klubet sportive të femrave;*
 - *Integrim i minoriteteve në aktivitete dhe gara sportive;*
 - *Integrim i personave me nevoja të veçanta në aktivitete dhe gara sportive;*
 - *Mbështetje e aktiviteteve sportive për fëmijët e Podujevës;*
 - *Përkrahje e projekteve me qëllim të zhvillimit të ligave shkollore në nivel lokal dhe rajonal.*
- **Ngritja e kapacitetit në fushën e sportit**
 - *Përkrahje e klubeve sportive;*
 - *Përkrahje e sportistëve kulmorë dhe klubeve të suksesshme;*
 - *Bashkëpunim me organizata të ndryshme sportive, vendore dhe ndërkombëtare, me qëllim të realizimit të projekteve për avancimin e trajnerëve, të cilët punojnë me grup moshë të ndryshme;*
 - *Ngritje e nivelit profesional të klubeve sportive;*

- Aktivitete edukative me simpatizantë me qëllim të evitimit të dhunës dhe kultivimit të vlerave fisnike të sportit.
- **Organizime sportive; Promovimi i Vullnetarizmit**
- **Edukime joformale (stimulimi i të miturve për edukim dhe arsim)**
 - Trajnim
 - Punëtori
 - Debat
 - Tryezë
 - Ligjëratë
 - Hulumtim
 - Simpozium
 - Konferencë

Objektivi i thirrjes:

Përfshirja e individëve, iniciativave, grupeve dhe OJQ-ve në krijimin, masivizimin, rritjen e cilësisë, zgjerimin/shtrirjen e ngjarjeve/aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive si dhe përmirësimin e qasjes dhe përfshirjes së grupeve të marginalizuara.

Objektivat:

- *Krijimi i ngjarjeve/aktiviteteve kulturore, artistike dhe rinore nëpërmjet partneritetit me individët dhe grupet në fushat e kulturës, rinis dhe sportit*
- *Përfshirja ideve dhe potencialit të individëve dhe grupeve kulturore, sportive dhe rinore në funksion të masivizimi të ngjarjeve dhe aktiviteteve tradicionale;*
- *Rritja e cilësisë së krijimtarive në kulturë, sport dhe aktivitete rinore, nëpërmjet mbështetjes së ideve, propozimeve dhe ngjarjeve/aktiviteteve;*
- *Shtrirja dhe zgjerimi i ngjarjeve/aktiviteteve në zona rurale;*
- *Përmirësimin e qasjes dhe përfshirjes në ngjarje/aktivitete të grupeve të marginalizuara;*

4. Vlera totale e planifikuar e thirrjeve për subvencione në projektet **Kulturë, Rini dhe Sport** për këtë Thirrje Publike është **85,000 €** (Euro).

5. **Kulturë dhe Rini:** Vlera totale e planifikuar e thirrjeve për subvencione për këtë vit është **20,000 €** (Euro).

Shuma minimale e mbështetjes financiare në projektet kulturore dhe rinore që mund të alokohet për çdo projekt është **500 €** (Euro), ndërsa shuma maksimale për një projekt është **7,000 €** (euro).

6. **Sport:** Vlera totale e planifikuar e thirrjeve për subvencione për këtë vit është **65,000 €** (Euro).

Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo projekt është **500 €** (Euro), ndërsa shuma maksimale për një projekt është **9,000 €** (euro).

7. Afati për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune, nga data 11.07.2024 dhe përfundon me datën 31.07.2024 në ora 16:00.

8. OJQ-të mund të aplikojnë vetëm me një projekt.

Perioda e zbatimit të projektit është prej nënshkrimit të kontratës deri më 27.12.2024.

Kriteret për pjesëmarrje në thirrjen publike të subvencioneve për Kulturë, Rini dhe Sport:

- OJQ-të të cilat veprojnë në Republikën e Kosovës;
- Klubet, Shoqatat sportive, të cilat veprojnë në Komunën e Podujevës dhe realizojnë aktivitetin e tyre në Komunën e Podujevës;
- OJQ-të mund të subvencionohen vetëm një herë brenda vitit nga Komuna e Podujevës;
- OJQ-të të cilët nuk e kanë përmbyllur raportin e subvencioneve të viteve paraprake nuk kanë të drejtë të përfitojnë nga subvencionet e Komunës së Podujevës në këtë thirrje dhe nuk mund të përzgjidhen fituese;
- Të mos kenë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete;
- Projektet duhet të reflektojnë nevojat dhe objektivat e Komunës së Podujevës për këto fusha;
- Të mos ekzistoj konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës;
- OJQ-të nuk mund të përfitojnë me dy ose më shumë projekte nga subvencionet e Komunës së Podujevës brenda një viti, qoftë edhe në kategori të ndryshme. Si dhe kufizimet e parapara me rregulloren për subvencione në Komunën e Podujevës;
- OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushat si të cekura më lartë. OJQ-të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj Komunës së Podujevës dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike;

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendari tregues i zbatimit të thirrjes, janë të detajuara në [Rregulloren për subvencione](#).

Kujdes: Aplikacionet të cilat nuk e kanë dokumentacionin e kompletuar do të diskualifikohen. Dokumentet nuk pranohen pas mbylljes së thirrjes publike.

Ngarkimi i dokumentit të gabuar ose jo të skanuar mirë, me pamje jo të qartë konsiderohet si mungesë e dokumentit. Nuk do të pranohet ndryshimi i subjektit të aplikantit nga individ në cilindo variant tjetër, pas përfundimit të aplikimit. E njëjta vlen edhe për ndryshim të xhirollogarisë.

Të gjithë aplikantët të cilët kanë ndërruar të dhënat e tyre duhet të sigurohen që t'i përditësojnë informatat e tyre në sistem gjatë periudhës së afatit të aplikimit për subvencione.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara sipas thirrjes publike.

Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: *jakup.gashi@rks-gov.net* dhe *arber.sfishta@rks-gov.net* ose në hapësirat e DKRS në objektin e Komunës.

Lista e dokumenteve të thirrjes publike

➤ **Për OJQ-të, klube/shoqata:**

- Certifikata e regjistrimit të OJQ-së;
- Certifikata e nr. fiskal;
- Vërtetimi/Konfirmimi i llogarisë bankare të OJQ-së (nuk pranohet kopje e kartelës bankare);
- Kopjen e letërnjoftimit/ pasaportës të përfaqësuesit të OJQ-së.
- Vërtetimin që OJQ/klubi/shoqata nuk ka obligime tatimore (nga ATK).
- Vendimin e regjistrimit të klubit/shoqatës në DKRS (vetëm për OJQ dhe klube sportive)
- Formulari i sportit (vetëm për OJQ-të dhe klube sportive) <https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2024/07/FORMULARI-PER-SPORT.docx>
- Deklarata për financimin e dyfishtë <https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2024/07/DEKLARATE-MBI-FINANCIMIN-E-DYFISHTE.docx>
- Deklarata e partneritetit: <https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2024/07/DEKLARATA-E-PARTNERITETIT.doc>
- Formulari i projekt propozim thirrjes publike (vetëm për OJQ-të në kulturë dhe rini). <https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2024/07/FORMULARI-I-PROJEKT-PROPOZIMIT-TE-THIRRJES-PUBLIKE.docx>
- Formulari i propozim buxhetit. <https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2024/07/FORMULARI-I-PROPOZIM-BUXHETIT.docx>
- Udhëzuesi për aplikuesit e thirrjes publike: <https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2024/07/Udhëzuesi-per-aplikuesit-e-thirrjes-publike-kulturerini-dhe-sport-KORRIK-2024.docx>

Vërejtje/Kujdes:

- ❖ **Raporti Narrativ** - i cili përfshin dëshmi nga projekti i aktivitetit qoftë nëpërmjet dëshmive të fotografimit. Ky raport duhet të plotësohet dhe të nënshkruhet nga Personi që ka nënshkruar marrëveshjen për subvencione. Raporti duhet të dorëzohet pas përfundimit projektit.

Raporti narrativ i përgatitur duhet të deklarohet dhe:

- ◆ Të përfshij dokumentacion mbështetës (si foto, regjistrime të ndryshme të aktiviteteve, etj).
- ◆ Të nënshkruhet nga një person në pozicion drejtues të subjektit grantmarrës

- ❖ **Raporti Financiar** – kërkohet që të përmbushen obligimet e raportit financiar njëjtë sikurse të gjitha subjektet tjera juridike. Në përputhje me Ligjin nr. 04/L-57 të gjitha OJQ-të e regjistruara në Departamentin për OJQ, të cilave në vazhdim iu është dhënë Statusi i Përfitimit Publik duhet të përgatisin një raport vjetor të projektit.

Raporti financiar i përgatitur duhet të deklarohet dhe:

- ◆ Të përshkruajë shpenzimet në përputhje me buxhetin origjinal duke reflektuar shpenzimet e kërkuara dhe ato të kryera;
- ◆ Të përshkruaj çdo pajisje të blerë;
- ◆ Të evidentoj çdo fond të pashpenzuar (të cilat duhet të kthehen ose për të cilat kërkohet shtyrje e afatit të përdorimit);
- ◆ Të nënshkruhet nga një person në pozicion drejtues.
- ❖ Të gjitha aplikimet të cilat nuk do ta kenë dokumentacionin e kompletuar nuk do të merren parasysh.
- ❖ Ju lutemi që raportin ta shkruani në formë elektronike (të printuara).
Raportet me dorëshkrim nuk pranohen.
- ❖ **Dokumentet e kompletuara dërgohen në zyrën pritëse, kati i parë në Komunën e Podujevës, në zarfe të mbyllura.**
- ❖ Nuk do merren në shqyrtim OJQ-të, të cilat nuk janë treguar të përgjegjshme në deklarin dhe formën e mbajtjes së aktivitetit në vitet paraprahe.
- ❖ Vetëm projektet që janë në përputhshmëri me kriteret për aplikim të cekura më lartë, do të procedohen për shqyrtim nga komisioni i përzgjedhur.

Këtë mund ta bëni dorazi ose nëpërmjet shërbimit postar. Adresa është e njëjtë në të dyja rastet:

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
Rruga "Nuhi Gashi", Kutia postare 1001

Në zarf të shkruhet qartazi:

Drejtuar Zyrës së Shërbimit për qytetarë në Komunën e Podujevës:
Aplikim në kuadër të Thirrjes për projekt-propozime për vitin 2024

Emri i aplikantit: _____

Titulli i projektit: _____

**DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT, DO TË VAZHDOJ
PROCEDURAT E REALIZIMIT TË THIRRJES PUBLIKE KONFORM
DISPOZITAVE TË PËRCAKTUARA LIGJORE.**

DREJTORESHË
e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Vlora Humo
Vlora Humo



Komuna e Podujevës | Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport